



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:262582

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05643277

C-IV.-13-3676

Ankuesi:

N S (për bashkëshortin e ndjerë R S) nga Prizreni.

Kundër

Pala kundërshtare:

N.SH “Liria”, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rruga “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Dr.sc. Murat Hulaj, me dt.29 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e ankuesit dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit nr.PRZ041-0558 të dt.11 nëntor 2013.
- 2. Në këtë çështje nuk caktohen taksa gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me dt.11 korrik 2014, ankuesi kishte paraqitur kërkesë për rishikim të vendimit në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit nr. PRZ041-0558 të dt.11 nëntor 2013, me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensim për 50 paga të pa paguara në shumë prej 6,400.00€ nga N.SH “Liria” (në likuidim). Ankuesi në ankesë ka pohuar se vendimi është marr me verifikim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pasi që i njëjti ka themeluar marrëdhënie të punës me dt.04.02.1984 deri me dt.30.11.2010, dhe likuidimi i kësaj ndërmarrje është bërë prej vitit 2013 e që afati i paraqitjes së kërkesave rrjedh prej kësaj date. Prandaj, dhe kërkesa për kompensim është e afatshme. Ankuesi së bashku me ankesë ka bërë dorëzimin e Librezës së punës.

E paditura ka paraqitur mbrojtjen e saj me dt.02 tetor 2018, në të cilën pohoi se padia përveç pohimeve padia nuk ka asnjë përmbajtje ligjore, është e pa argumentuar dhe e pa mbështetur në prova materiale. Paditësi ka theksuar se ka qenë punëtor aktiv mirëpo nuk ka sjellë prova mbështetëse për të dëshmuar këtë fakte. Ka shtuar se kërkesa e ankuesit është parashkruar konform nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Ka propozuar që të refuzohet kërkesëpadia e ankuesit dhe të vërtetohet vendimi i AL-së.

Me dt.02 nëntor 2021, gjykata i ka dërguar ankuesit një urdhër përmes të cilit ka kërkuar që të bëjë dorëzimin e vendimit të AL-së të cilin e ka atakuar, si dhe prova shtesë në mbështetje të pretendimeve ankimore.

Bashkëshortja e paditësit me dt.16 nëntor 2021 i është drejtuar gjykatës me parashtresë duke e njoftuar gjykatën se bashkëshorti i saj ka ndërruar jetë dhe ka kërkuar që ankesa e tij të aprovohet si e bazuar. Së bashku me të ka bërë dorëzimin e këtyre provave: Kopjen e vendimit të atakuar, Aktvendimin e trashëgimisë LRP.nr.8313/2016 T.nr.ref.1725/2016 dt.05.09.2016, Regjistër llogaritar të lëshuar nga NSH "Liria" nr.144, nr.113, nr.86.

Me dt.22 shkurt 2024, gjykata lëshoj një urdhër për ankuesin përmes të cilit kërkoj nga i njëjti që të bëjë dorëzimin e prova shtesë që dëshmojnë që NSH-ja i ka mbetur borxh paga të cilat i kërkon, njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, listën e pagave që dëshmon se i njëjti ka pranuar pagë nga NSH-ja. N S iu ka përgjigjur këtij urdhri, duke sjellë përsëri kopjen e aktvendimit të trashëgimisë, certifikatën e vdekjes së ankuesit, kopjen e vendimit të atakuar, kopjen e vendimit PRZ041-0763 dt.04.10.2013, si dhe kopjen e librezës së punës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL-së.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtresat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa par.3 parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse palët e tilla dështojnë që të paraqesin apo dorëzojnë provat e tilla, atëherë vlerësohet se palët nuk kanë përmbushur barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti se ankuesi ishte punëtor i NSH-së, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmojë se i takon kompensimi për 50 paga të pa paguara. Ankuesi së bashku me ankesë dhe me parashtrësia ka bërë dorëzimin e Kopjen e vendimit të atakuar, Aktvendimin e trashëgimisë LRP.nr.8313/2016 T.nr.ref.1725/2016 dt.05.09.2016, Regjistër llogaritar të lëshuar nga NSH “Liria” nr.144, nr.113, nr.86, librezës së punës.

Nga kjo gjykata vjen në përfundim që parashtruesi i ankesës nuk i ka përmbushur kriteret themelore të ankesës. Ankuesi do të mund të dorëzonte prova relevante në mbështetje të pretendimeve të tij ankimore, siç është njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës si dhe kopja e listës së pagave të cilat ankuesi i ka pranuar nga NSH-ja si dhe kopjen e listës së pagave të cilat ankuesi pretendon se NSH-ja i ka mbetur borxh. Gjykata gjen se, në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për 50 paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura në provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara. Ankuesi ka bërë dorëzimin e provave me të cilat nuk dëshmohet e drejta e pretenduar.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore:

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore me dt.06.12.2021.

Këshillë juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtari
Dr.sc.Murat Hulaj